

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin Mustaf Tahiri dhe procesmbajtësen Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh.S. nga fshati komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje pushtim i paligjshëm i pronës së palujtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II.nr.977-6/13 të dt. 08.11.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë publik, në praninë e prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit S.S.1 av.V.A. si dhe të akuzuarit Xh.S., më datë 27.01.2017 mori dhe komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri, **XH.S.** nga fshati komuna Ferizaj, data e lindjes.....në fshatin, nga i ati R. dhe e ëma A., e vajzërisë F., pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse gjatë vitit 2012 e deri më datën 26.04.2013, në mënyrë të kundërligjshme e ka pushtuar pronën e palujtshme të të dëmtuarit S.S.1 të identifikuar me çertifikatën nr.UL-72217039-0213, në vendin e “Gurina”, në fshatin në sipërfaqe prej 27.69 ari Zona Kadastrale –, e identifikuar me çertifikatën mbi pronën e palujtshme të lëshuar nga Komuna Ferizaj me dt.04.07.2010,

Me këtë kishte për të kryer veprë penale pushtim i paligjshëm i pronës së palujtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së

I dëmtuari S.S.1 nga fshati komuna Ferizaj, me vendqëndrim në Leskoc, rr. “.....“ nr....., i përfaqësuar nga avokati V.A. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.977-6/13 të dt.08.11.2013 ka ngarkuar të pandehurin, Xh.S. nga fshati komuna Ferizaj për shkak të veprës penale pushtim i paligjshëm i pronës së palujtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 16.12.2016 në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit Ismet Rrahmani lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën konform nenit 325 të KPPK-së, të njëjtëve i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari Xh.S. në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shtuar se jeton në fshatin komuna Ferizaj që nga viti 1965 dhe posedon pronë dhe prona e tij është në emrin e prindit të tij. Pronat të cilat i ka në fshatin kufizohen me shumë persona. I dëmtuari S.S.1 nuk e di por sigurisht se ka prona në fshatin I akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se për këtë çështje ka dhënë një deklaratë para prokurorit të shtetit. I njëjti ka deklaruar se pronën për të cilën akuzohet nuk e ka uzurpuar e as nuk e ka kositur e nuk e ka shfrytëzuar si kullosë, përveq atyre viteve që ka paguar qira dhe atë gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015 këtë pronë e ka shfrytëzuar por gjatë kësaj kohe ka pasur marrëveshje me Agjencionin Kosovar të Pronës (tutje AKP). I njëjti ka deklaruar se këtë palujtshmëri nuk e ka shfrytëzuar para vitit 2013 dhe nuk e din se kush e ka shfrytëzuar të njëjtën para vitit 2013. I akuzuari po ashtu në mbrojtjen e tij ka deklaruar se gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015 ka pasur marrëveshje me AKP e cila marrëveshje ka qenë në emrin e djalit të tij S.S.2 dhe për këtë kohë sa e ka shfrytëzuar ka paguar qiranë AKP-së nga 20€ në vitë.

Gjykata pas administrimit dhe vlersimit të provave një nga një dhe në lidhëshmerinë e tyre reciproke gjeti se nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I dëmtuari S.S.1, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se deri në vitin 1999 ka jetuar në fshatin komuna Ferizaj dhe është pronar i palujtshmërisë në vendin e quajtur "Gurina" në fshatin në sipërfaqe prej 27.69 ari, të cilën prone e ka shfrytëzuar deri në vitin 1999. I Njëjti ka deklaruar se pas vitit 1999 ka ardhur në mënyrë të organizuar me organizata joqeveritare me një person të quajtur R. duke e vizituar kohë pas kohe mirpo nuk e ka pare dhe nuk e din se kush e ka shfrytëzuar këtë palujtshmëri, duke shtuar se nuk ka pasur ndonjë marrëveshje as me shkrim e as me gojë me askënd për shfrytëzimin e kësaj palujtshmërie. Përsonin me emrin Xh.S. e din që është nga fshati ndoshta edhe e njoh mirpo për shkak të kohës së kaluar nuk mund ta njoh as si figure vetëm e dij që është nga fshati, mirpo me të njëjtin nuk ka pasur ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e palujtshmërisë dhe se nuk e din nëse i akuzuari Xh.S. pas vitit 1999 e ka shfrytëzuar këtë palujtshmëri apo jo. I dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pas vitit 1999 nuk e din kush e ka shfrytëzuar këtë palujtshmëri dhe për këtë e ka paraqitur rastin në Zyrën për Përkrahje dhe Implementim të Strategjive për Përsona të Zhvendosur Intern dhe të Kthyerve ku vetëm I ka njoftuar se kush janë mexhanikët e kësaj palujtshmërie mirpo tani emrat nuk më kujtohen. I dëmtuari poashtu ka deklaruar se disa organizata më kanë thënë nëse jam I interesuar që palujtshmerinë ta jap në shfrytëzim me qera mirpo I njëjti ju ka thënë se nuk është I interesuar që ta jap me qera për 10-20€. I dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se asnjëher nuk ka marrë asnjë kompensim për shfrytëzimin me qera të palujtshmerisa nga AKP-ja.

Përfaqësuesi i Agjencionit Kosovar të Pronës me autorizim A.H. në shqyrtimin gjyqësor të datës 16.12.2016 ka deklaruar se lidhur me rastin konkret i dëmtuari S.S.1 në vitin 2007 ka parashtruar kërkesën pranë AKP-së për riposedimin e pronës me nr.297-0 me sipërfaqe prej 27.69 ari dhe se në kërkesën e tij nuk ka paraqitur ndonjë emër që e ka uzurpuar pronën e tij dhe bashkë me kërkesën ka paraqitur provat se është pronar i palujtshmërie. Komisioni për kërkesa pronësore pranë AKP-së në vitin 2010 ka aprovuar kërkesën e të dëmtuarit dhe në vitin 2011 lënda është zbatuar është implementuar me dorëzimin e kësaj palujtshmërie nën administrimin e AKP-së. AKP ka mandatin që të njejtën pronë që i është lënë nën administrim ta lëshon me qera përsonave të caktuar të cilët kanë interes dhe në këtë rast Agjencioni ka bërë marrëveshje për shfrytëzimin e kësaj prone me Xh.S.. Agjencioni në këtë rast ka për detyrë që qiranë e mbledhur nga kontrata me shfrytëzuesin tia dorëzoj pronarit apo parashtruesit të kërkesës dhe në agjencion konsiderohet se rasti është mbyllur dhe nuk ka arsye të veproj përveç mbledhjes së qirasë. Përfaqësuesi i AKP-së në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se tani statusi i tanishëm i pronës së palujtshme në vendin e quajtur Gurina në sipërfaqe prej 27.69 ari është palutshmëri nën administrimin e AKP-së, sipas marrëveshjes me shrim posedues faktik është përsone S.S.2 me të cilën AKP ka marrëveshje dhe të cilat marrëveshje janë njëveqare dhe të cilat rinovohen, për të cilat sipas rregullave të AKP-së pagesa e qirasë nga qiramarrësi bëhet në llogari të veçant të AKP-së e pastaj AKP-ja këto para ja dorëzon pronarit apo parashtruesit të kërkesës. Ndërsa në shqyrtimin e datës 13.01.2017 përfaqësuesi i AKP-së A.H. i ka dorëzuar gjykatës dokumentacionin e agjencionit lidhur me qiranë dhe pagesën e qirasë dhe atë kopjen e transaksioneve për pagesën e qirasë për vitin 2013, 2014 dhe 2015 dhe kopjet e transaksioneve për kthimin e pagesave nga llogaria e të dëmtuarit S.S.1 për shkak siq ka deklaruar përfaqësuesi i AKP-së mosfunskonimit të llogarisë bankare në emër të dëmtuarit S.S.1.

Gjykata ka refuzuar propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit S.S.1 avokatit V.A. që gjykata të del në vendin e ngjarjes në vendin e quajtur “Gurina” në fshatin pasi që i akuzuari në bazë të dispozitivit të aktakuzës është akuzuar për veprën penale për periudhën prej vitit 2012 e deri më 26.04.2013 dhe gjykata nuk e ka parë të arsyeshme dhe të nevojshme që me daljen tani gjykata në vendin e ngjarjes nuk mund ta verteton ndonjë fakt i cili sipas akuzës pretendohet të ketë ndodhur në vitin 2012 dhe 2013.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor të dt.27.01.2017 ka deklaruar se heq dorë nga dëgjimi i dëshmitarit të propozuar në aktakuzë S.S.2, pasi që për të njejtin është bërë verifikimi nga Policia e Kosovës – Stacioni në Ferizaj ku është njoftuar gjykata se i njejt gjendet jashtë shtetit andaj pasi që i njejt është i paaritshëm për gjykatën i ka propozuar gjykatës aë i njejt të mos dëgjohe dhe heq dorë nga dëgjimi si dëshmitar.

Gjykata në cilësi të provave në këtë shqyrtim gjyqësor ka adminstruar edhe provat materiale dhe atë certifikatën e pronës së palujtshme nr.UL-72217039-00213, kontratën mbi qiranë për pronën e palujtshme ndërmjet Agjencisë Kosovare të Pronës të datës 24.04.2013, kontratën mbi qiranë për pronën e palujtshme ndërmjet Agjencisë Kosovare të Pronës të datës 25.03.2014, kontratën mbi qiranë për pronën e palujtshme ndërmjet Agjencisë Kosovare të Pronës të datës 26.03.2015, rrjedha e pagesave të transaksioneve bankare nga AKP-ja për palujtshmërinë në vendin e quajtur “Gurina” për vitet 2013, 2014 dhe 2015 si dhe kopjen e

transakcioneve për kthimin e pagesave nga AKP-ja në llogarinë e S.S.1it të cilat transkacione janë siguruar nga AKP-ja si dhe historia dhe statusi i nxjerrë nga AKP-ja e pronës për vendin e quajtur Gurina në emër të dëmtuarit S.S.1.

Gjykata me kujdes të veçant e vlerësoi dëshminë e të dëmtuarit S.S.1 dhe vlerësoi se kjo dëshmi e të dëmtuarit pjesërisht është e mbështetur edhe në prova tjera të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor siq është prova materiale çertifikata e pronës së palujtshme nr.UL-72217039-00213. Gjykata në rastin konkret nuk e konteston faktin se i dëmtuari është pronar i kësaj palutshmerie dhe se që nga viti 1999 nuk e shfrytëzon me këtë palujshmeri. Gjykata ka vlerësuar me kujdes të veçant edhe deklarimin e tij kur është pyetur nëse ka njohuri për atë nese i akuzuari ka shfrytëzuar apo jo palujtshmerinë e tij dhe faktin se i dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e din nëse i akuzuari Xh.S. e ka shfrytëzuar apo jo palujtshmerinë e tij dhe se i njeiti nuk ka pasur ndonjë marëveshje me të lidhur me shfrytëzimin e kësaj palujtshmerie, pra i dëmtuari në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk e din nëse i akuzuari e ka shfrytëzuar pronën e tij.

Gjykata me kujdes të veçant ka vlerësuar edhe provat tjera materiale siq janë kontratat mbi qiranë për pronën e palujtshme ndërmjet Agjencisë Kosovare të Pronës të datës 26.04.2013, 25.03.2014 dhe 26.03.2015 ku është vërtetuar fakti se në të tri këto kontrata apo marëveshje mbi qiranë për pronën e palujtshme AKP-ja sipas nenit 16 të rregullores së UNMIK-ut nr.2006/10 të ndryshuar me rregulloren 2006/50 dhe nenit 12 të rregullores së UNMIK-ut 200/60, të përshtatur në ligjin 03/L-079 ka lëshuar marëveshje mbi qiranë për pronës bujqësore dhe se këto marëveshje janë bërë në mes S.S.2 me nr.letërnjoftimi si qiramarrës dhe Agjencisë Kosovare të Pronës si qiramarrës ku palët janë marrë vesh ku qiramarrësi (AKP) i ka lëshuar me qera Qiramarrësit (S.S.2) vetëm për qëllime bujqësore pronën e cila gjendet në fshatin në vendin e quajtur Kamena 297 Ferizaj me sipërfaqe prej 2,769,00 metra katror me përshkrimin e lëndës së qirasë, kohëzgjatjen e qirasë kushtet dhe pagesat e qirasë për vitet 2013, 2014 dhe 2015.¹ Poashtu nga rrjedha e trasakcioneve bankare vërtetohet se është bërë pagesa vjetore sipas viteve 2013, 2014 dhe 2015.²

Gjykata po ashtu vlerësoi me kujdes edhe pretendimin fjalës përfundimtare e prokurorit të shtetit dhe vëren se prokuroria nuk ka aritur të ofroj prova të mjaftueshmeme të cilat plotësohet standardi i të provuarit në një procedurë penale. Gjykata ka vlerësuar këto prova të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor në unitet njëra me tjetrën dhe bazuar në nenin 361 të KPP-së i cili përcakton mënyrën e çmuarjes së provave, vlerësimin e fuqisë provuese dhe vërtetësisë së tyre në bazë të përmbajtjes së secilës dhe bindjes së brendshme të gjykatës, arrin në konkluzionin se ndryshe nga ç'pretendohet nga akuza, nuk provohet tej çdo dyshimi të bazuar që e pandehuri të ketë kryer veprën për të cilën akuzohet duke mos aritur që të ofroj asnjë provë materiale që do ta lidhte të akuzuarin Xh.S. me veprën penale pushtim i pronës së palujtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së dhe se pretendimet e prokurorit të shtetit nuk mbështetet me provat e ofruara dhe të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor.

¹ Shih marëveshjet mbi qiranë për pronën bujqësore të datës 26.04.2013, 25.03.2014 dhe 25.03.2015.

² Shih rrjedhën e transakcioneve bankare.

Gjykata pretendimin tjetër të prokurorit të shtetit në fjalën përfundimtare se i pandehuri edhe më heret nga deklarimi i tij “dhënë në hetuesi” dhe në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari ka shfrytëzuar tokën pronë e të dëmtuarit...” edhe ky pretendim sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret gjykata ka zbatuar nenin 262 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, sa i përket provave për caktimin e fajsisë, ku decivisht thuhet se gjykata nuk e shpallë të akuzuarin fajtor duke u mbeshetur vetem në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimare deklaratës të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit. Në rastin konkret gjykata ka analizuar dhe vlerësuar deklaratën e të akuzuarit Xh.S. të dhënë para prokurorit të shtetit mirpo edhe në këtë deklaratë i pandehuri ka deklaruar njëjtë si në shqyrtimin gjyqësor se palujtshmërinë në vendin e quajtur “Gurina” në sipërfaqe 25-26 ha është e vërtet se e ka shfrytëzuar por këtë e ka shfrytëzuar pasi që i njëjti kishte pasur marrëveshje me AKP-në, andaj sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret ka për oblogim ligjor që të provojë në mënyrë të pa kontestueshme të gjitha faktet të cilat janë në favor dhe disfavor për të akuzuarin, duke i nderlidhe edhe me prezunimin e pafajsisë dhe me parimin “in dubio proreo” mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për qeshtjen duhet të interpretohen në favor të të akuzuarit bazuar në këtë gjykata nuk gjeti asnjë provë që deshmohet fajsia e të pandehurit, andaj në baze të kesaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1. 3 të KPPK-së.

I dëmtuari S.S.1 nga fshati komuna Ferizaj, me vendqëndrim në Leskoc, rr. “.....“ nr....., i përfaqësuar nga avokati V.A. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.1726/13 të dt. 27.01.2017

Procesmajtësja,
Drita Ujupi

G j y q t a r i,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.